



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITSHËM VLORË**

Nr. 3407 Prot.

Vlorë më, 24.02.2026.

NJOFTIM PËR VEND VAKANT PËR PUNONJËS MIRMBAJTËS
/me kontrat 6 orëshe në ditë/

Në zbatim të ligjit Nr 97 dt.06.10.2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (nenet 42,71,e në vijim), Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, kërkon të punësojë një punonjës në administratë me detyrë punonjës mirmbajtës, me kontrat 6 (gjashtë) orë pune në ditë, e cila përfundon në 31.12.2026.

Përshkrimi i punës:

Kushtet e përgjithshme:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale, si dhe të mos jetë nën hetim;
- dh) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga detyra që nuk është shuar sipas afateve të parashikuara në ligjit;
- e) Të ketë pëfunduar arsimin e mesëm;

Përshkrimi i punës:

Punonjësi mirëmbajtës duhet të kryej detyrën me përgjegjshmëri dhe korektesë të lartë, me qëllim mirëmbajtjen dhe eliminimin e defekteve që konstatohen në godinë duke përmbyllur të gjitha kërkesat si më poshtë :

- a) Të marrë masat për mirëmbajtjen e godinës së Prokurorisë dhe ambjenteve të jashtme në funksion të saj.
- b) Për çdo parregullsi të konstatuar vepron sipas rastit, vetë dhe njofton eprorët për veprimet e kryera, ose njofton punonjësin e interesuar.
- c) Kryen riparimin dhe vendosjen e bravave të dyerve dhe dritareve.
- d) Kryen riparimin e defekteve të paisjeve higjieno-sanitare të tualeteve.
- e) Kryen riparimin e defekteve të ndryshme të aparateve të kondicionerëve që nuk kërkojnë

shërbim të specializuar.

- f) Kryen riparimin e defekteve të vogla elektrike.
- g) Në rastet kur meret specialist nga jashtë, qëndron në mbështetje të tyre ndjek punimet, merr në fund të punimeve pjesët e vjetra që dalin nga riparimet dhe raporton te eprorët për përfundimin e punimeve.
- h) Kryen lëvizjet e paisjeve (kur lind nevoja) në ambjentet e Prokurorisë.
- i) Ndhmonë në lëvizjet dhe sistemimin e mallrave të ndryshme në magazinë.
- j) Kryen edhe detyra të tjera të dhëna nga eprorët.

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë këto dokumenta:

- a) Kërkesë për punësim.
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së mesme.
- e) Dëshmi penaliteti.
- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht.
- g) Fotokopje të librezës së punës.
- h) Vërtetim vendbanimi.
- i) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, deri në datën 12.03.2026 ora 08:00-16:00 duke konfirmuar marrjen në dorëzim sipas inventarit të akteve të dorëzuara.

Verifikimi paraprak i kandidatëve do të bëhet nga Kancelari i Prokurorisë, e cili pasi të marrë praktikat dokumentare për secilin kandidat duhet të verifikojë nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e kërkuara.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet nga Komisioni i Pranimi bazuar në dokumentacionin e secilit kandidat, si dhe rezultati i intervistës me secilin kandidat, do të kryhet në ambjentet e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në datën që do të vendoset nga komisioni i pranimi të cilët do të njoftohen me telefon ose e-mail nga Kryesekretaria.

Për çdo sqarim mund të paraqiteni në ambjentet e kësaj Prokurorie çdo ditë nga dita e hënë deri ditën e premte nga ora 08.00 - 16.00, (ku do të gjeni edhe njoftimin të afishuar në hyrje të Prokurorisë), ose vizitoni faqen e internetit eepp.gov.al/Vlore, ku do të publikohet kjo shpallje.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

